



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr.

Prishtinë, më 14 maj 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Halit Krasniqi dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Amir Ahmeti dhe Mufera Shinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Petrit Hysaj dhe Lejla Selimi – OSBE, Fjolla Krasniqi dhe Fitore Sadiku – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.04.2012;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestuese;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.04.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11. 04. 2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin Nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin Nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestuese

Kryetari propozoi të formohet një grup punues për shqyrtimin e këtij projektligji. Propozoi Albulena Haxhiun dhe Jasmina Zhivkoviq.

Ardian Gjini—Propozoi që në grupin punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për procedurën kontestuese ta drejtojë Halit Krasniqi.

Albulena Haxhiu— Nuk u pajtua që të jetë anëtare grupit punues, sepse me Halit Krasniqin jemi ballafaquar shumë herë dhe nuk mendoj se punojmë mirë bashkë, duke pasur parasysh praktikat e kaluara.

Halit Krasniqi— Tha se për arsye të konstruktivitet tërhiqet nga kryesimi grupit punues, pasi nuk dëshiron ta pengojë kontributin që mund të japë Albulena Haxhiu.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri këtë:

Përfundim

Formohet Grupit Punues në këtë përbërje: Halit Krasniqi – kryesues, Haki Demolli dhe Jasmina Zhivkoviq - anëtarë.

5. Të ndryshme

Kryetari- Foli për vendimin e Presidentit për rishikimin e neneve 37 dhe 38 të kodit penal. Ai tha se ende nuk e kemi marrë në mënyrë zyrtare nga Kryesia e Kuvendit.

Albulena Haxhiu -Ngriti shqetësimin e saj lidhur me Kompanitë e Sigurimit, sipas ligjit për Sigurimin e automjeteve janë të obliguara që t'i japin Kryqit të Kuq nga 0.1 % nga mjetet që mbledhin për sigurimin e veturave, deri tash asnjë kompani nuk e ka përmbushur obligimin ligjor. Besoi se ne, si Komision, kemi kompetencën që t'i drejtohem BKQ – së për këtë çështje, dhe pastaj ajo t'i detyrojë kompanitë e sigurimeve ta përmbushin detyrimin e tyre.

Kryetari – Duke u ndërlidhur me parafolësen tha se kjo është detyrë e Komisionit Funkcional dhe se nuk është në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion.

Armend Zemaj- Theksoi se duke pasur parasysh edhe shqetësimet e fundit që janë ngritur nga ana e deputetëve dhe mediave, lidhur me Ligjin për Ekzekutimin Sanksioneve Penale, propozoi që si Komision ta vizitojnë njërin nga shërbimet korrektuese, p.sh. Dubravën, sepse do të ishin më afër për të parë si po zbatohet ky ligj.

Albulena Haxhiu- Propozoj që të vizohet edhe burgu për femra në Lipjan.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri këtë:

P ë r f u n d i m

Ngarkohet deputeti Armend Zemaj që të koordinojë dhe të caktojë kohën e përshtatshme për të vizituar institucionet korrektuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi